



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Kuvendi Komunal Klinë

Nr. 060-19970/26

Klinë, datë: 24.06.2024

## PROCESVERBAL

**Nga dëgjimi i tetë buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në fshatin Zllakuqan, me banorët e fshatrave Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë dhe Rudicë, në hapësirën e shkollës së mesme të ulët "Atë Shtjefën Gjeçovi", datë 10.06.2024, ora 17:30.**

Të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Tanushi – Selmanaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Urbanizimit, Enver Berisha, drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, drejtori i Administratës, Binak Sylaj, anëtarë të grupit punues si dhe banorë të zonave të lartcekura.

I pranishëm ishte edhe këshilltari i Kuvendit Komunal Klinë, z. Tunë Dedaj.

Materialin e diskutimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, u shpërnda në formë fizike nga anëtarët e grupit punues.

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, i cili, pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, foli gjerësisht mbi rëndësinë e këtyre takimeve buxhetore. Ai theksoi se këto takime janë të rregulluara nga ligjet në fuqi dhe se ato u japin qytetarëve të drejta të rëndësishme për hartimin sa më transparent dhe gjithëpërfshirës të buxhetit dhe investimeve të komunës.

Në fjalën e tij, Kryetari Elezaj vendosi theksin te rëndësia e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në këtë proces. Ai shpjegoi se përfshirja e qytetarëve në hartimin e buxhetit është jetike për të siguruar që resurset financiare të komunës të përdoren në mënyrë efektive dhe në përputhje me nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Përfshirja e qytetarëve jo vetëm që rrit transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, por gjithashtu forcon besimin dhe bashkëpunimin midis qytetarëve dhe administratës komunale.

Duke folur për projektet aktuale në këto fshatra, Kryetari Elezaj informoi banorët se shumë projekte të tjera janë në fazën përfundimtare dhe pritet kompletimi i rrugëve fushore dhe kanalizimit, ndërsa pritet të investohet në ndriçim dhe trotuarë.

Prezantimi i këtyre projekteve po bëhet për të siguruar që takimi të jetë sa më produktiv dhe efikas. Kjo mundëson që diskutimi të shtrohet dhe fokusohet në projektet e reja dhe të mos përsëriten kërkesat e qytetarëve.

Sa i përket projeksioneve për vitet 2025-2027, Kryetari Elezaj theksoi se këto projeksione do të dalin nga kërkesat e takimeve me qytetarët. Ai theksoi se presin komente, pyetje, sugjerime dhe kërkesa nga ana e banorëve, sepse mbahet procesverbali dhe të gjitha do të regjistrohen dhe do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve. Me këtë rend dite, ai hapi diskutimin.

### **1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.**

Më kërkesë, fjala për hapjen e diskutimeve ju dha banorit, Bujar Mehmeti.

**Bujar Mehmet, fshati Rudicë:** Përshëndetje kryetar dhe ju të pranishëm drejtorë të drejtorive, si përfaqësues i fshatit Rudicë, në emër të banorëve po paraqes këto kërkesa, e para ndërtimi i **trotuarit në rrugën Budisalc-Rudicë**, ndërtimi i **urës e cila lidh fshatin Budisalc dhe Rudicë** pasi kalimi është mjaftë i vështirë, intervenimi në disa pjesë në rrjetin e ujit të pijës si dhe në mundësitë buxhetore të shihet si prioritet **ndërtimi i kanalit të ujitjes**. Ju falënderoj shumë!

**Tunë Dedaj, fshati Deiq:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmi, i nderuar kryetar dhe ju drejtorë të drejtorive, fillimisht ju falënderoj për takimin. Jam në Zllakuqan sepse për shkak të angazhimeve nuk kasha mundësi të jem në takimin në Zajm, ku janë thirrur edhe banorët nga fshati Deiq. Unë po e paraqes si kërkesë të cilën do ta shtrojë edhe gjatë mbajtjes së seances në kuvend e ajo është, **trotuari në rrugën Krushevë- Zllakuqan**.



**Tomë Kqiraj, fshati Berkovë:** Përshëndetje kryetar, kam një kërkesë, **shtrimin e një rruge me zhavorr.**

Fjala për vazhdimin e debatit më pas ju dha banorit, Nrec Përnoka.

**Nrec Përnoka, fshati Zllakuqan:** Përshëndetje kryetar dhe juve të pranishëm drejtorë, kam kërkesë për **rregullimin e shtratit të lumit “Drini i Bardhë”, ose të paktën të bëhet pastrimi**, kërkesa vjen sin pasojë e vërshimeve që kanë ndodhur në shumë rajone të komunës së Klinës, po ashtu edhe tek ne, andaj të rregullohet pjesa e pronave afër kishës.

**Gjokë Dodaj, fshati Leskoc:** Kërkesë për **sanim të gropave në rrugët Zllakuqan, Ranoc dhe Leskoc si dhe investim në kablo të përquesve të rrymës.**

**Kryetari Elezaj, përgjigjet:** Po Gjokë e kuptojë që qëndroni shumë keq, po unë e kam përcjellë kërkesën në KEDS, bësojë që shumë shpejtë do të bëhet intervenimi, pasi si fshat jeni në rend sepse komuna është shumë e kufizuar të ndërhyjë në sistemin apo rrjetin e energjisë elektrike.

**Mirush Zefi, fshati Ranoc:** Përshëndetje kryetar po ndërlidhem edhe unë menjëherë tek kjo pjesa e enërgjisë elektrike sepse edhe ne kemi **nevojë për investime të tilla në rrjet.**

**Pren Balaj, Ranoc:** Përshëndetje, i nderuar kryetar dhe ju drejtorë të drejtorive, pasi edhe gjendeni në hapësirat e shkollës **“Atë Shtjefën Gjeçovi”**, si staf i kësaj shkolle kërkojë **ndërtimin e palestrës në këtë shkollë.**

**Nënkryetarja Marqe Tanushi-Selmanaj:** Përshëndetje të nderuar, po ndërlidhem me fjalne parafolësit, z. Balaj, përveç kërkesës së ndërtimit të palestrës për këtë shkollë, ekziston edhe nevoja që të shihen mundësitë financiare **për renovimin e tërsishëm të saj apo edhe ndërtimin e shkollës së re.**

**Kryetari Zenun Elezaj:** Aka dikush tjetër që dëshironë të merr fjalën?

Nëse jo, atëherë e shpalli të mbyllur takimin sepse pas gjithë këtij diskutimi, unë nuk kam se çfarë të shtojë me shumë, por presim prape kërkesa çofshin me shkrim apo me email për të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësinë me qenë sot të pranishëm, deri me datën 21 qershor.

Pas përfundimit të fazës së dëgjimeve publike buxhetore, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik nga anëtarë e grupit punues si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Ju falënderoj shumë çdonjërin këtu për pjesëmarrjen tuaj!

**Takimi u mbyll në ora 18:12.**

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 17 persona, më gjithsej njëmbëdhjetë kërkesa të regjistruara.

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

<b>Gra</b>	<b>3</b>
<b>Burra</b>	<b>14</b>
<b>Totali</b>	<b>17</b>

**Procesmbajtësja,**

**Vlora Tafili**

